Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) lidhur me nenin 17, paragrafi 1, pika (f) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 10 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2011" i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për mbeturina "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 29/2022", e konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, 28.02.2023 miratoi këtë;

V E N D I M
Për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

Neni 1
MIRATOHET- Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027 (në tekstin e mëtejmë PKMM).

Neni 2
Pjesë përbërëse e këtij vendim është edhe Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027 (në tekstin e mëtejmë PKMM), me numër të protokollit 01-Nr-016-7967 i datës 02.02.2023, i përgatitur nga grupi punues i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.

Neni 3
Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për shërbime publike mjedis dhe emergjencë të Komunës e Suharekës.

Neni 4
Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N S Ë N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr- 016-14452
Me datë 28.02.2023

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI

REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI I KOMUNËS SUHAREKË
REPUBLIC OF KOSOVA MUNICIPALITY OF SUHA REKA
REPUBLIKA KOSOVA SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA